

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E DIGJITALIZIMIT DHE ADMINISTRATES PUBLIKE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **202-26-5604-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria ri-tender”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	PBC SH.P.K.
NUI	810845985
Adresa	Rruga Bekim Fehmiu, 91
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044467467
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Selmani
Adresa elektronike	bs@pbc.group
Data e parashtrimit të ankesës	11.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Ankesa i përket grupeve:

“Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria ri-tender”

Njoftim për kontratë: 20.07.2026

Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 27.07.2026

Kërkesë për sqarime shitesë: 06.08.2026

Informacione dhe sqarime shitesë: 12.08.2026

Kërkesë për rishqyrtim: 28.08.2026

Vendimi në kërkesën për rishqyrtim: 02.09.2026

Afati fillestar për dorëzimin e ofertave: 31.08.2026

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 14.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar më datë 25.08.2026, ndërsa vendimi i AK-së për kërkesën për rishqyrtim është publikuar më datë 02.09.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3;

Neni 27, paragrafi 1;

Neni 28, paragrafët 1, 2 dhe 8;

Neni 70;

Neni 51, paragrafët 1 dhe 3; si dhe

Neni 53, paragrafët 4–6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Nenet 17.12, 24.4, 24.7, 25.5 dhe 25.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Hyrje

PBC, në cilësinë e operatorit ekonomik me interes të drejtpërdrejtë për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit, pas përfundimit të procedurës paraprake sipas nenit 108/A të LPP-së, paraqet këtë ankesë pranë OSHP-së kundër:

1. Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 02.09.2026; dhe

2. Dosjes së Tenderit, e cila:

- përmban kritere të kualifikimit të paarsyetuara si të domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, të cilat kufizojnë konkurrencën;
- përmban specifikime teknike dhe detyrime kontraktuale të paqarta, të papërcaktuara dhe të pamatshme, pa sasi, kufij maksimalë, parametra teknike dhe kritere objektive të pranimit, duke cenuar përgatitjen dhe krahasueshmërinë e ofertave;

II. Dispozitat e shkelura

- Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3;
- Neni 27, paragrafi 1;
- Neni 28, paragrafët 1, 2 dhe 8;
- Neni 70;
- Neni 51, paragrafët 1 dhe 3; si dhe
- Neni 53, paragrafët 4–6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.
- Nenet 17.12, 24.4, 24.7, 25.5 dhe 25.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

III. Pretendimet ankimore

PBC i mban në tërësi pretendimet materiale të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 25.08.2026. Ato paraqiten dhe shtjellohen më poshtë sipas kësaj renditjeje: pretendimi dhe baza faktike/ligjore – përgjigjja e AK-së në vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim – kundërshtimi ndaj përgjigjes së AK-së – provat dhe ekspertizat relevante, sipas rastit – përfundimi dhe kërkesa.

Pretendimi I – Kufizimi i pajustificuar i diplomave

Në Dosjen e Tenderit, për pozitat **Analist i Sistemit, Arkitekt i Softuerit dhe Ekspert për zhvillimin dhe konfigurimin e Ueb-shërbimeve dhe Web API**, është kërkuar diploma “Inxhinier i Kompjuterikës me Telekomunikacion ose Master i Shkencave Kompjuterike ose Master i Inxhinierisë Kompjuterike”. Për secilën pozitë kërkohen njëkohësisht minimumi tri vite përvojë profesionale dhe së paku një projekt i natyrës së ngjashme.

PBC përmes kërkesës për informacione shtesë, kërkoi që të pranohen edhe kandidatët me diplomë **Bachelor** në Shkenca Kompjuterike, Inxhinieri Kompjuterike, Inxhinieri Softuerike, Teknologji Informative, Telekomunikacion ose fushë tjetër relevante dhe ekuivalente. AK-ja u përgjigj vetëm se **kërkesat mbesin të njëjta** dhe janë në harmoni me natyrën e aktivitetit dhe LPP-në.

Përgjigjja e AK në kërkesën për informacione shtesë nuk jep **bazë konkrete teknike ose ligjore**. Së pari, **nuk shpjegon** pse niveli **Bachelor** nuk është i mjaftueshëm për

pozitat e kërkuara, veçanërisht kur për secilën prej tyre kërkohej njëkohësisht përvojë profesionale dhe projekt i natyrës së ngjashme. Kërkesa që kandidati të ketë **Master/MSc** ose diplomë të sistemit të vjetër katërvjeçar si prag minimal **përfshijte** kandidatët me **Bachelor**, pa u dëshmuar se ky kufizim është i domosdoshëm për kryerjen e detyrave. Së dyti, AK-ja nuk shpjegon pse drejtimet e diplomave kufizohen në emërtimet e përcaktuara, në vend që të pranohen edhe drejtimet relevante ose ekuivalente, në përputhje me detyrat konkrete të secilës pozitë.

Kërkesa për **Master/MSc** ose për titullin e lidhur me sistemin e vjetër katërvjeçar nuk duhet të mbetet prag minimal eliminues, sepse një kufizim i tillë **e redukton konkurrencën**. Niveli minimal duhet të jetë **Bachelor** në një fushë relevante, ndërsa Master/MSc dhe diploma universitare e sistemit të vjetër katërvjeçar duhet të pranohen si alternativa të barasvlershme, jo si kusht minimal. Kjo mundëson që niveli i arsimit të kombinohet në mënyrë proporcionale me përvojën profesionale dhe projektin e ngjashëm që kërkohej veçmas.

Kriteri, pa arsyetim objektiv të lidhur me detyrat e secilës pozitë, nuk rezultoi i kufizuar në atë që është e domosdoshme për realizimin e kontratës dhe cenon nenet 7 dhe 51 të LPP-së. Neni 25.6 i Rregullores vetëm e konkretizon këtë detyrim ligjor duke kërkuar që kriteret minimale të jenë **drejtëpërdrejt relevante dhe proporcionale** me objektin e kontratës.

Kriteret e vitit 2022 dëshmojnë se Master/MSc nuk është konsideruar i domosdoshëm

Kriteret aktuale e reduktojnë konkurrencën dhe paraqesin ashpërsim të paarsyetuar krahasuar me kriteret që vetë AK-ja ka zbatuar më parë për mirëmbajtjen dhe përkrahjen e të njëjtit sistem. Në Dosjen e Tenderit të vitit 2022, për pozitat e stafit kërkohej diploma universitare në Shkenca Kompjuterike ose drejtime ekuivalente, pa u përcaktuar **Master/MSc** si nivel minimal i arsimit.

Në Dosjen e Tenderit të vitit 2022, kriteret arsimore për stafin formuloheshin si diplomë universitare në Shkenca Kompjuterike ose drejtim ekuivalent, ndërsa në dokumentet dëshmuuese për pozitat përkatëse përcaktohej shprehimisht minimumi **Bachelor**. Pra, kërkesat për stafin pranonin drejtimet ekuivalente dhe nuk përcaktonin **Master/MSc**, titullin specifik “Inxhinier i Kompjuterikës me Telekomunikacion” apo diplomën e sistemit të vjetër katërvjeçar si prag minimal.

Kjo praktikë e mëparshme e AK-së për të njëjtin sistem dëshmon se realizimi i kontratës nuk është kushtëzuar nga niveli **Master/MSc**, por nga kombinimi i arsimit relevant me përvojën profesionale dhe kërkesat e tjera përkatëse. **Në procedurën aktuale, AK-ja nuk ka identifikuar ndonjë ndryshim konkret në natyrën ose kompleksitetin e detyrave që do ta bënte të domosdoshëm ngritjen e nivelit minimal të arsimit.**

Prandaj, përjashtimi i kandidatëve me diplomë **Bachelor** në fusha relevante ose ekuivalente **nuk rezultoi i lidhur me ndonjë nevojë të re** dhe të dokumentuar të kontratës. Krahasimi me kriteret e vitit 2022 përbën provë konkrete se kërkesa aktuale për **Master/MSc** ose për titullin specifik të sistemit të vjetër katërvjeçar nuk rrjedh vetvetiu nga natyra e sistemit dhe, në mungesë të një arsyeimi objektiv, nuk është e nevojshme dhe proporcionale sipas neneve 7 dhe 51 të LPP-së. Përkundrazi,

këto kritere kanë efekt kufizues dhe e reduktojnë konkurrencën, duke përjashtuar kandidatët me diplomë Bachelor në drejtime relevante ose ekuivalente dhe duke favorizuar OE-në e përmendur më lart.

Për arsyet dhe faktet e lartcekura, kërkojmë që kërkesa minimale për **Master/MSc** ose për diplomë të sistemit të vjetër katërvjeçar të largohet dhe kriteri arsimor të zëvendësohet me formulimin: "Minimum **Bachelor** ose Master/MSc ose diplomë universitare e sistemit të vjetër katërvjeçar, në drejtim relevant ose ekuivalent". Konkretisht, të pranohen:

- diplomë **Bachelor** në drejtimet e lartcekura ose ekuivalente.

Përgjigjja e përmbledhur e AK-së në vendimin e kërkesës për rishqyrtim:

AK e mbështet kufizimin në kompleksitetin dhe përgjegjësinë teknike të roleve, duke iu referuar analizës së avancuar, projektimit të arkitekturës, integritetit të sistemeve, sigurisë, performancës dhe zgjidhjes së problemeve komplekse. AK deklaron se "niveli Master kërkohet për të siguruar njohuri të avancuara dhe kapacitete analitike në përputhje me kompleksitetin dhe përgjegjësitë e këtyre pozitave kyçe."

Kundërshtimi ndaj përgjigjes së AK-së në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigjja e AK-së mbetet e përgjithshme dhe nuk demonstroi domosdoshmërinë e nivelit Master për detyrat konkrete të pozitave të kontestuara. AK nuk ka identifikuar asnjë detyrë teknike specifike për Menaxherin e Projektit, Analistin e Sistemit apo Arkitektin e Softuerit, për realizimin e së cilës niveli Master do të ishte objektivisht i domosdoshëm, dhe as nuk ka shpjeguar pse e njëjta detyrë nuk mund të realizohet nga një kandidat me diplomë Bachelor në fushë relevante ose ekuivalente, krahas përvojës së kërkuar.

Vetë referimi në kompleksitetin e sistemit, përgjegjësinë e roleve apo nevojën për njohuri të avancuara nuk mjafton për ta bërë kriterin proporcional. Sipas neneve 7 dhe 51 të LPP-së, kriteri duhet të jetë jo vetëm i lidhur me objektin e kontratës, por edhe i nevojshëm, drejtpërdrejt relevant dhe proporcional me detyrat që duhet të realizohen.

Po ashtu, referimi i AK-së në nenin 69.6.1 nuk e zëvendëson detyrimin për ta arsyetuar proporcionalitetin e kriterit akademik në këtë kontratë të shërbimeve. Çështja thelbësore nuk është nëse AK ka të drejtë të kërkojë kualifikim akademik, por nëse niveli Master si prag minimal eliminues është objektivisht i domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Raporti i Ekspertit Shqyrtues/Teknik në lëndën OSHP nr. 2026/0645 është veçanërisht relevant, pasi trajton pothuajse të njëjtën çështje juridike dhe faktike. Në atë procedurë ishte kontestuar kërkesa që për Menaxherin e Projektit, Analistin e Sistemit dhe Arkitektin e Softuerit të pranohej "Inxhinier i Kompjuterikës me Telekomunikacion" ose Master në Shkenca/Inxhinieri Kompjuterike, duke përjashtuar Bachelor-in relevant.

Eksperti ka konstatuar se AK **nuk kishte identifikuar ndonjë detyrë teknike specifike** për këto pozita për të cilën niveli Master do të ishte domosdoshmërisht i nevojshëm dhe që nuk do të mund të realizohej nga një kandidat me **Bachelor relevant dhe përvojën e kërkuar**. Eksperti ka vlerësuar gjithashtu se arsyetimi i përgjithshëm mbi kompleksitetin e sistemit nuk ishte i mjaftueshëm për ta justifikuar këtë kufizim dhe ka rekomanduar pranimin e diplomave Bachelor ose ekuivalente në fushat relevante, së bashku me përvojën e kërkuar.

Po ashtu, AK nuk ka arritur të shpjegojë apo arsyetojë se çfarë ndryshimi konkret në natyrën, kompleksitetin apo përgjegjësitë e kontratës ka ndodhur krahasuar me procedurën e vitit 2022 për të njëjtin sistem, kur niveli Master nuk ishte përcaktuar si kriter minimal.

Provat:

1. Raporti i Ekspertit Shqyrtues/Teknik në lëndën OSHP nr. 2026/0645;
2. Dosja e Tenderit e vitit 2022 për mirëmbajtjen dhe përkrahjen e të njëjtit sistem e-Pasuria;
3. Vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim, datë 02.09.2026.

Përfundimi dhe kërkesa:

Bazuar në faktet, argumentet dhe provat e lartcekura, kërkojmë nga OSHP ta aprovojë këtë pretendim si të bazuar dhe ta obligojë AK-në që, në pajtim me detyrimet që burojnë nga nenet 7 dhe 51 të LPP-së për ruajtjen e konkurrencës dhe përcaktimin e kriterëve të nevojshme, relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës, të pranojë për pozitën e kontestuar si kusht minimal arsimor diplomën Bachelor në drejtime ekuivalente, krahas përvojës së kërkuar.

Pretendimi II – Dyshimi i bazuar për përshtatjen e kriterëve

Mënyra e formulimit të kriterëve krijon dyshim të arsyeshëm se Dosja e Tenderit dhe kërkesat për diploma mund të jenë përshtatur në favor të **OE DataProgNet**, përkatësisht stafit që ky operator mund ta propozojë. Ky dyshim lidhet posaçërisht me kufizimin e diplomave në **Master/MSc** ose në titullin “Inxhinier i Kompjuterikës me Telekomunikacion”, që mund të korrespondojë me sistemin e vjetër katërvjeçar, ndërkohë që përjashtohen diploma **Bachelor** në fusha drejtpërdrejt relevante.

Dyshimi përforcohet nga fakti se AK-ja, edhe pas kërkesës së drejtpërdrejtë, **nuk ka dhënë arsyetim teknik** për lidhjen e këtij kufizimi me detyrat e pozitive dhe as analizë të proporcionalitetit. Efekti real është reduktimi i konkurrencës dhe përjashtimi i ekspertëve me përvojë e kualifikime të përshtatshme, vetëm për shkak të emërimit ose nivelit formal të diplomës.

Përgjigjja e AK-së në vendimin e kërkesës për rishqyrtim:

Për të gjithë stafin është specifikuar niveli i arsimit dhe se përfshihet edhe “arsimimi ekuivalent”, duke iu referuar Dosjes së Tenderit.

Kundërshtimi ndaj përgjigjes së AK-së në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim

Kjo përgjigje nuk e trajton substancën e pretendimit për efektin kufizues të kriterit. Termi **“ekuivalent”** nuk e eliminon kufizimin, sepse në kontekstin e kërkesës ai i referohet një kualifikimi të barasvlershëm me **Master/MSc ose diplomën universitare të sistemit të vjetër katërvjeçar**, dhe jo automatikisht diplomës Bachelor sipas sistemit të Bolonjës. Përderisa Bachelor-i nuk pranohet shprehimisht, kriteri vazhdon të përjashtojë ekspertët që kanë **përvojën e kërkuar**, por posedojnë diplomë Bachelor në drejtim relevant.

Përfundimi dhe kërkesa:

Bazuar në faktet, argumentet dhe provat e lartcekura, kërkojmë nga OSHP ta aprovojë këtë pretendim si të bazuar dhe ta obligojë AK-në që, në pajtim me detyrimet që burojnë nga nenet 7 dhe 51 të LPP-së për ruajtjen e konkurrencës dhe përcaktimin e kriterëve të nevojshme, relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës, të pranojë për pozitën e kontestuar si kusht minimal arsimor diplomën Bachelor në drejtime ekuivalente, krahas përvojës së kërkuar.

Pretendimi III – Përfshirja e sqarimeve për kodin burimor në Dosjen e Tenderit

AK, në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim, ka konfirmuar se **e posedon versionin më të fundit dhe të plotë të kodit burimor**. PBC e konsideron këtë çështje të sqaruar, por kërkon që kjo informatë **të përfshihet shprehimisht në Dosjen e Tenderit të korrigjuar**, si pjesë e dokumentacionit zyrtar dhe e aplikueshme në mënyrë të barabartë për të gjithë OE-të.

Pretendimi IV – Metodologjia është bërë kërkesë e qartë vetëm përmes sqarimit

Dosja kërkon dokumentin për Planin e Menaxhimit të Projektit, duke përfshirë resurset njerëzore. Në përgjigjen nr. 3, AK-ja sqaroi se ky plan duhet të dorëzohet gjatë ofertimit dhe duhet të përmbajë edhe metodologjinë e menaxhimit të projektit.

Nëse metodologjia është element obligativ për përgjegjshmërinë e tenderit, përmbajtja minimale, mënyra e vlerësimit dhe pasojat e mungesës së saj duhet të jenë të qarta në Dosjen e Tenderit. OE-të duhet të dinë nëse kontrollohet vetëm ekzistenca e dokumentit apo edhe cilësia e përmbajtjes dhe nëse kërkohen zgjidhje konkrete për avancime që ende nuk janë përcaktuar.

Në bazë të nenit 27 dhe nenit 53 të LPP-së, kërkesat materiale duhet të rezultojnë qartë nga dokumentet e tenderit dhe sqarimet duhet të shërbejnë për qartësim, jo

për vendosjen e një kriteri të ri të papërcaktuar. Neni 24.7 i Rregullores e konkretizon këtë duke kërkuar që ndryshimet ose përmirësimet e Dosjes të publikohen përmes formularit B54.

Kërkojmë që AK-ja ta përfshijë shprehimisht metodologjinë në Dosjen e Tenderit, ta përcaktojë **përmbajtjen minimale** dhe **mënyrën e vlerësimit** dhe të konfirmojë se kërkohet metodologji e menaxhimit dhe organizimit, jo zgjidhje teknike për funksionalitete ende të panjohura.

Përgjigjja e AK-së në vendimin e kërkesës për rishqyrtim:

Kërkohet Plan i Menaxhimit të Projektit, ku përcaktohen metodologjia e realizimit, organizimi, përgjegjësitë dhe resurset njerëzore të angazhuara me kualifikim dhe përvojë adekuate për zbatimin e projektit. Shihe dosjen e tenderit dhe sqarimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues më datë 12.08.2026 duhet të lexohen së bashku me Dosjen e Tenderit dhe dokumentet tjera të publikuara në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit. Sqarimet e dhëna kanë për qëllim të qartësojnë kërkesat ekzistuese dhe nuk mund të interpretohen të shkëputura nga përmbajtja e plotë e Dosjes së Tenderit dhe janë pjesë përbërëse e këtij AP-je.

Kundërshtimi ndaj përgjigjes së AK-së në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim

Përgjigjja konfirmon elementet e përgjithshme, por nuk përcakton përmbajtjen minimale të detyrueshme, mënyrën objektive të vlerësimit dhe pasojat e mungesës apo pamjaftueshmërisë së tyre. Pretendimi se një kërkesë materiale është bërë e qartë vetëm përmes sqarimit mbetet i patrajtuar, veçanërisht në raport me detyrimin për pasqyrim të ndryshimeve në dokumentet e tenderit.

Provat:

1. Dosja e Tenderit;
2. Sqarimi i datës 12.08.2026 .

Përfundimi dhe kërkesa.

Bazuar në faktet, argumentet dhe provat e lartcekura, kërkojmë nga OSHP ta aprovojë këtë pretendim si të bazuar dhe ta obligojë AK-në që, në pajtim me detyrimet që burojnë nga nenet 27 dhe 53 të LPP-së dhe neni 24.7 i Rregullores për Prokurimin Publik, të përfshijë në mënyrë të qartë në Dosjen e Tenderit përmbajtjen minimale të detyrueshme dhe mënyrën e vlerësimit të Planit/Metodologjisë së Menaxhimit të Projektit, në mënyrë që kjo kërkesë të jetë e qartë, e njëjtë dhe e zbatueshme për të gjithë operatorët ekonomikë.

Pretendimi V – Vëllimi dhe kufijtë e punëve janë të papërcaktuar

Dosja e obligon OE-në që gjatë përkrahjes t'u përgjigjet dhe t'i implementojë **“të gjitha kërkesat për avancim/ndërhyrje”** të AK-së, përfshirë ndryshime në të gjitha modulet. PBC kërkoi përcaktimin e numrit ose vëllimit maksimal të kërkesave, kompleksitetit, moduleve, mekanizmit të miratimit dhe trajtimit të kërkesave që tejkalojnë vëllimin e kontraktuar.

AK-ja i ndau në mënyrë të përgjithshme mirëmbajtjen nga funksionalitetet e reja, por **nuk dha asnjë kufi sasior**. Në vend të përcaktimit të vëllimit dhe kufijve të kërkesave, u përgjigj “varësisht nga kërkesat e institucioneve, gjatë gjithë orarit zyrtar të punës dhe në raste emergjente edhe pas orarit të punës”. Për kërkesat përtej vëllimit u përgjigj vetëm se do të trajtohen “sipas dosjes së tenderit”, ndonëse dosja nuk e përcakton atë vëllim.

Kështu, OE duhet të japë çmim për **30 muaj** pa ditur numrin ose vëllimin e kërkesave, zhvillimeve, integriteteve, moduleve dhe nivelin maksimal të kompleksitetit. Një OE mund ta llogarisë çmimin vetëm mbi mirëmbajtjen rutinore, ndërsa një tjetër mbi zhvillime të shumta e të pakufizuara. Ofertat nuk përgatiten mbi bazë të njëjtë dhe **nuk janë realisht të krahasueshme**.

Kjo bie ndesh drejtpërdrejt me nenin 27, paragrafi 1 dhe nenin 28, paragrafi 8 të LPP-së. Përdorimi i termave të përgjithshëm “sipas nevojës”, “të gjitha kërkesat” ose “gjatë implementimit” nuk e zëvendëson detyrimin ligjor për një fushëveprim minimal, të matshëm dhe të çmueshëm. Nenet 17.12, 19.1 dhe 19.4 të Rregullores vetëm e konkretizojnë këtë detyrim.

Praktika relevante e OSHP-së – rastet 2025/0780 dhe 2025/1198

E njëjta çështje juridike dhe teknike është trajtuar në rastet nr. **2025/0780** dhe **2025/1198**. Në këto raste, numri i moduleve, avancimeve, trajnimeve, ndërlidhjeve dhe funksionaliteteve të reja ishte lënë për t'u përcaktuar gjatë implementimit.

Në Raportin e Ekspertit Shqyrtues nr. **2025/0780**, eksperti konstatoi se mungonin elementet bazë të kërkesave funksionale dhe ekzekutive, numri minimal i moduleve dhe nën-moduleve, paramasat e avancimeve dhe kufijtë e punës. Eksperti vlerësoi se objekti i kontratës ishte i papërcaktuar, se OE-të nuk mund të kalkulonin çmime të bazuara në punë reale dhe se dosja duhej të plotësohej me specifikime të qarta funksionale dhe jofunksionale.

Me Vendimin nr. **2025/0780**, të datës 17.10.2025, OSHP-ja e aprovoi ankesën si të bazuar, anuloi njoftimin për kontratë dhe urdhëroi AK-në të bëjë përmirësimet në Dosjen e Tenderit dhe ta zgjasë afatin për ofertim.

Pas ndryshimeve të bëra nga AK-ja, çështja u trajtua përsëri në lëndën **2025/1198**. Raporti i ekspertit konstatoi se lënia e parametrave të ardhshëm në diskrecionin e institucionit e mbante objektin e kontratës të papërcaktuar në vëllim dhe kompleksitet dhe se dosja duhej të përmbante specifikime minimale dhe kufij të qartë për punët shtesë. Eksperti rekomandoi që ankesa të aprovohej pjesërisht, AK-ja të bënte përmirësime dhe të zgjaste afatin. Vendimi nr. 2025/1198 evidencon se të dyja palët u pajtuan me raportin dhe se AK-ja duhej ta implementonte atë. Prandaj ky rast nuk paraqitet gabimisht si vendim i ri meritator mbi çdo pretendim, por si konfirmim procedural i pranimin dhe zbatimit të ekspertizës.

Rastet janë relevante jo sepse kanë të njëjtin sistem informativ, por sepse trajtojnë të njëjtën çështje: kërkimin e mirëmbajtjes, avancimeve dhe funksionaliteteve të reja pa sasi, parametra dhe kufij të mjaftueshëm për kalkulimin e çmimit dhe planifikimin e resurseve. Për rrjedhojë, AK-ja duhet të zbatojë të njëjtin standard të qartësisë edhe në procedurën për sistemin e-Pasuria.

Kërkojmë që AK-ja të përcaktojë së paku:

- numrin apo vëllimin maksimal të kërkesave;
- kategoritë dhe kufijtë ndërmjet mirëmbajtjes, avancimit dhe funksionalitetit të ri;
- nivelin maksimal të kompleksitetit dhe modulet që mund të preken;
- afatet e reagimit dhe realizimit sipas kategorive;
- mekanizmin e evidentimit, vlerësimit dhe miratimit të kërkesave dhe ndërhyrjeve;
- mënyrën e pagesës ose kontraktimit të kërkesave përtej vëllimit të përfshirë.

Përgjigjja e AK-së në vendimin e kërkesës për rishqyrtim:

Ndërhyrjet që konsiderohen pjesë e përkrahjes dhe mirëmbajtjes së rregullt përfshijnë: identifikimin dhe eliminimin e defekteve, korrigjimin e gabimeve në sistem, monitorimin e funksionimit të sistemit, përditësimeve, mirëmbajtjen preventive, konfigurimin dhe rikonfigurimin e komponentëve, avancimet dhe ndryshimet bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe bazuar në ndryshimet e procedurave dhe proceseve të punës. Avancime ose zhvillim i funksionaliteteve të reja konsiderohen ndërhyrjet që përfshijnë zhvillimin, implementimin ose integrimin e funksionaliteteve, moduleve, proceseve apo mundësive të reja në sistem, të cilat nuk kanë qenë pjesë e funksionaliteteve ekzistuese të sistemit në momentin e lidhjes së kontratës. Ndërhyrjet parashihen të realizohen kryesisht në modulet ekzistuese të sistemit, pa kërkuar ristrukturim të plotë të sistemit. Ndërhyrjet pritet të përfshijnë përmirësimin dhe përshtatjen e funksionaliteteve ekzistuese, si dhe, sipas nevojës, integrimin e disa funksionaliteteve të reja. Ndërhyrjet do të kërkohen përmes kërkesave të zyrtarëve të institucioneve në nivel qendror dhe lokal. Kërkesat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga ASHI, ndërsa realizimi i ndërhyrjeve do të bëhet nga OE vetëm pas miratimit të tyre nga ASHI. Shihe dosjen e tenderit dhe sqarimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues më datë 12.08.2026 duhet të lexohen së bashku me Dosjen e Tenderit dhe dokumentet tjera të publikuara në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit. Sqarimet e dhëna kanë për qëllim të qartësojnë kërkesat ekzistuese dhe nuk mund të interpretohen të shkëputura nga përmbajtja e plotë e Dosjes së Tenderit dhe janë pjesë përbërëse e këtij AP-je.

Kundërshtimi ndaj përgjigjes së AK-së në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim

Përgjigjja e AK-së sqaron në mënyrë të përgjithshme kategoritë e ndërhyrjeve dhe mekanizmin e miratimit të tyre, por **nuk përcakton kufirin sasior, funksional apo ekonomik të detyrimeve që do të përfshihen në çmimin e kontratës.** Formulimet si

“kryesisht”, “sipas nevojës” dhe “disa funksionalitete të reja” nuk përcaktojnë një vëllim maksimal të matshëm dhe të çmueshëm të punëve.

Po ashtu, fakti që kërkesat do të shqyrtohen dhe miratohen nga ASHI përcakton vetëm **mekanizmin e autorizimit të ndërhyrjeve**, por nuk përcakton kufirin e punës që OE duhet ta përfshijë në çmimin e ofertës për periudhën 30-mujore. Për rrjedhojë, mbetet e pazgjidhur çështja thelbësore e ngritur në pretendim: **operatorët ekonomikë duhet të kalkulojnë çmimin dhe resurset pa pasur të përcaktuar një minimum dhe maksimum të matshëm të ndërhyrjeve, avancimeve dhe funksionaliteteve të reja që mund të kërkojnë gjatë zbatimit të kontratës.**

Provat:

1. Raporti i Ekspertit Shqyrtues nr. 2025/0780;
2. Vendimi nr. 2025/0780;
3. Raporti i Ekspertit Shqyrtues nr. 2025/1198;
4. Raporti i Ekspertit Shqyrtues/Teknik nr. 2026/0645.

Të tri ekspertizat lidhen drejtpërdrejt me përgjigjen aktuale të AK-së. Fakti që kërkesat do të shqyrtohen dhe miratohen nga ASHI **nuk përcakton vëllimin** që OE duhet ta përfshijë në çmimin fiks të ofertës. Po ashtu, termat “kryesisht”, “sipas nevojës” dhe “funksionalitete të reja” **nuk vendosin kufi maksimal**. Prandaj, **mekanizmi i miratimit nuk e zëvendëson detyrimin** për të përcaktuar paraprakisht minimumin dhe kufijtë e ekspozimit kontraktual.

Përfundimi dhe kërkesa.

Bazuar në faktet, argumentet, provat dhe ekspertizat e lartcekura, si dhe në pajtim me nenet 27 dhe 28.8 të LPP-së dhe nenet 19.1 dhe 19.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, kërkojmë nga OSHP ta aprovojë këtë pretendim si të bazuar dhe ta obligojë AK-në që në Dosjen e Tenderit të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të matshme vëllimin e ndërhyrjeve, avancimeve dhe funksionaliteteve të reja që përfshihen në çmimin e ofertës, përfshirë kufijtë sasiorë dhe funksionalë të tyre, si dhe mënyrën e trajtimit të kërkesave që tejkalojnë këtë vëllim.

Pretendimi VI – ISO/IEC 20000-1:2018 kufizon konkurrencën

PBC kërkoi largimin e **ISO/IEC 20000-1:2018**, duke argumentuar se kapaciteti për ofrimin e shërbimeve dëshmohet edhe me ISO 9001, ISO/IEC 27001, përvojën, kontratat e ngjashme dhe stafin profesional. AK-ja u përgjigj vetëm se kriteri mbetet i njëjtë dhe është në harmoni me natyrën e aktivitetit dhe LPP-në.

Përgjigjja nuk analizon domosdoshmërinë, proporcionalitetin, ndikimin në konkurrencë ose mundësinë e dëshmive ekuivalente. Edhe nëse ISO/IEC 20000-1 lidhet në parim me menaxhimin e shërbimeve të TI-së, kjo nuk e përjashton

detyrimin e AK-së që ta arsyetojë pse certifikimi është **kriter eliminues** i domosdoshëm për këtë kontratë konkrete.

Kërkojmë që AK-ja ta largojë kërkesën për **ISO/IEC 20000-1:2018**, sepse vendosja e saj si **kriter eliminues**, pa u dëshmuar domosdoshmëria për realizimin e kontratës, e kufizon konkurrencën dhe nuk është proporcionale me objektin e prokurimit, në kundërshtim me nenet 7 dhe 51 të LPP-së.

Përgjigjja e AK-së në vendimin e kërkesës për rishqyrtim:

ISO/IEC 20000-1:2018 duhet të kërkohej krahas ISO 9001 dhe ISO/IEC 27001, sepse mbulon specifikisht menaxhimin e shërbimeve të TI-së, duke siguruar procese të standardizuara për ofrimin, mirëmbajtjen, mbështetjen, menaxhimin e incidenteve dhe vazhdimësinë e shërbimeve; ndërsa ISO 9001 fokusohet në menaxhimin e përgjithshëm të cilësisë dhe ISO/IEC 27001 në sigurinë e informacionit. Prandaj, këto standarde janë plotësuese dhe jo zëvendësuese, veçanërisht për kontrata që përfshijnë mirëmbajtjen dhe përkrahjen e sistemeve TI. Të cilat janë të arsyeshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

Kundërshtimi ndaj përgjigjes së AK-së në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim

Përgjigjja e AK-së shpjegon funksionin e përgjithshëm të standardit **ISO/IEC 20000-1:2018** dhe dallimin e tij nga ISO 9001 dhe ISO/IEC 27001, por **nuk e adreson çështjen thelbësore të ngritur nga PBC**, përkatësisht pse posedimi i këtij certifikimi duhet të jetë **kusht eliminues i domosdoshëm** për këtë kontratë konkrete.

Fakti që ISO/IEC 20000-1:2018 lidhet me menaxhimin e shërbimeve të TI-së nuk e dëshmon vetvetiu **domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin** e kërkesës. AK nuk ka identifikuar ndonjë detyrë, proces apo rrezik specifik të kontratës që nuk mund të mbulohet përmes standardeve të tjera të kërkuara, përvojës në kontrata të ngjashme, stafit profesional apo dëshmive të tjera ekuivalente të kapacitetit teknik.

Po ashtu, përgjigjja e AK-së nuk e trajton ndikimin që kërkitimi kumulativ i **ISO 9001, ISO/IEC 27001 dhe ISO/IEC 20000-1:2018** ka në konkurrencë dhe as mundësinë e pranimit të certifikatave apo dëshmive ekuivalente. Për këtë arsye, arsyetimi se standardet janë “plotësuese dhe jo zëvendësuese” nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar vendosjen e ISO/IEC 20000-1:2018 si kriter eliminues.

Përfundimi dhe kërkesa

Bazuar në faktet, argumentet dhe provat e lartcekura, si dhe në pajtim me nenet 7, 51 dhe 70 të LPP-së, kërkohej që OSHP ta aprovojë këtë pretendim si të bazuar dhe ta obligojë AK-në që ta largojë kërkesën për ISO/IEC 20000-1:2018 si kriter eliminues.

IV. Kërkesa drejtuar OSHP-së

Duke u bazuar në faktet, argumentet, provat, ekspertizat dhe dispozitat ligjore të shtjelluara më sipër, si dhe në kundërshtimet ndaj Vendimit të Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim të datës **02.09.2026**, PBC kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. **Ta aprovojë ankesën si të bazuar** dhe ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim, në pjesët e kundërshtuara.
2. Për **Pretendimin I dhe II**, ta obligojë AK-në që, në pajtim me nenet 7 dhe 51 të LPP-së, për pozitat **Analist i Sistemit, Arkitekt i Softuerit dhe Ekspert për zhvillimin dhe konfigurimin e Ueb-shërbimeve dhe Web API**, të pranojë si kusht minimal arsimor **diplomën Bachelor në drejtime relevante ose ekuivalente, krahas përvojës së kërkuar**, duke eliminuar kufizimet e paarsyetuara që reduktojnë konkurrencën.
3. Për **Pretendimin III**, ta obligojë AK-në që konfirmimin se posedon **versionin më të fundit dhe të plotë të kodit burimor** ta përfshijë shprehimisht në **Dosjen e Tenderit të korrigjuar**, si pjesë të dokumentacionit zyrtar dhe të aplikueshëm në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.
4. Për **Pretendimin IV**, ta obligojë AK-në që, në pajtim me nenet 27 dhe 53 të LPP-së dhe nenin 24.7 të Rregullores për Prokurimin Publik, të përfshijë në mënyrë të qartë në Dosjen e Tenderit **përmbajtjen minimale të detyrueshme dhe mënyrën e vlerësimit të Planit/Metodologjisë së Menaxhimit të Projektit**, në mënyrë që kërkesa të jetë e qartë, e njëjtë dhe e zbatueshme për të gjithë operatorët ekonomikë.
5. Për **Pretendimin V**, ta obligojë AK-në që, në pajtim me nenet 27 dhe 28.8 të LPP-së dhe nenet 19.1 dhe 19.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të përcaktojë në Dosjen e Tenderit **në mënyrë të qartë dhe të matshme vëllimin e ndërhyrjeve, avancimeve dhe funksionaliteteve të reja që përfshihen në çmimin e ofertës**, përfshirë kufijtë sasiorë dhe funksionalë të tyre, si dhe mënyrën e trajtimit të kërkesave që tejkalojnë këtë vëllim.
6. Për **Pretendimin VI**, ta obligojë AK-në që, në pajtim me nenet 7, 51 dhe 70 të LPP-së, **ta largojë kërkesën për ISO/IEC 20000-1:2018 si kriter eliminues**, për shkak se nuk është dëshmuar në mënyrë konkrete domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i saj për këtë kontratë.
7. Ta obligojë AK-në që të bëjë **ndryshimet dhe korrigjimet përkatëse në Dosjen e Tenderit**, t'i publikojë ato në përputhje me kërkesat ligjore dhe, sipas nevojës, **ta zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave**, në mënyrë që operatorët ekonomikë të kenë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave mbi bazën e dokumentacionit

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe jomateriale që i janë shkaktuar ose që mund t'i shkaktohen parashtruesit si pasojë e shkeljeve të pretenduara do të përcaktohen pas realizimit të një ekspertize përkatëse financiare.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*